



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 113/Prot.

Tiranë, më 15.05.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datë 15.05.2020, ditë e premte, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën on-line, lidhje Zoom, thirrur nga Kryetari bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mblodh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Znj. Nurihan Seiti
5. Z. Tartar Bazaj
6. Z. Bujar Sheshi
7. Z. Kosta Beluri
8. Z. Sandër Beci
9. Z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuoromit dhe kaloi në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:



1. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Alket Mersini.
2. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Ledina Riza
3. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Arben Allajbeu.
4. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Arben Dyla.
5. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Ardian Braho.
6. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Bujar Memia.
7. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Dritan Marku.
8. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Saimir Smaka.
9. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Genci Qana.
10. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar në vitin akademik 2020-2021, profili “prokuror”.
11. Miratimi i projektvendimit “Për bashkimin e procedurave administrative të filluara mbi bazën e vendimeve nr.19, datë 27.01.2020 dhe nr.92, datë 10.04.2020 të Këshillit.
12. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, për prokurorin Kreshnik Ajazi.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Beluri për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.



Z. Beluri relatton projektaktin e vlerësimit për pesë prokurorë. Nga shqyrtimi i pesë akteve të përzgjedhura dhe tre dokumenteve të shortuara për secilin nga këto subjekte, rezulton se:

- Për prokurorin Alket Mersini është marrë informacion për shkelje disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme; në raport nuk janë përfshirë ankesat.
- Për prokurorin Dritan Marku është marrë informacion për shkelje disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme; në raport janë shtjelluar dhe ankesat.
- Për prokuroren Ledina Riza është marrë informacion për shkelje disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme; në raport nuk janë shqyrtuar ankesat.
- Për prokurorin Ardian Braho është marrë informacion për shkelje disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme; ka patur një pezullim, i cili më pas është shuar; në raport nuk janë përfshirë ankesat.
- Për prokurorin Saimir Smaka është marrë informacion për shkelje disiplinore në Prokurorinë e Përgjithshme; në raport nuk janë përfshirë ankesat, në bazë të marrëveshjeve që janë bërë me organet përkatëse.

Komisioni ua ka shpërndarë anëtarëve të gjitha materialet në rrugë elektronike dhe ka arritur në konkluzionin që raportet janë të plota (origjinalet ndodhen në dosjen e protokolluar të seancës). Në këto kushte, z. Beluri i propozon Këshillit që t'i miratojë.

Z. Ibrahimi pasi merr pëlqimin e anëtarëve të Këshillit, vendos që projektaktet të kalojnë në votim. Përpara votimit, ai lexon vetëm një herë projektaktin që vlen për të gjithë subjektet, duke u plotësuar përkatësisht me emrat e secilit:

Bazuar në nenet 149/a, 179/b nenin “e” të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 189/1, gërrma “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së organeve të sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; neni 40, 42 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 71 dhe 94 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me raportet e përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, vendosi:

- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Ledina Riza.
- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Dritan Marku.
- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Ardian Braho.



- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Saimir Smaka.

Një kopje e këtyre vendimeve i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. (Origjinalet ndodhen në dosjen e protokolluar të seancës si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të KLP-së).

Z. Ibrahim i hedh në votim.

Miratohen me 9 vota pro.

Z. Ibrahim i jep fjalën znj. Keshi, për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Znj. Keshi relacionon se janë shqyrtuar pesë akte të shortuara dhe tre dokumente të dorëzuara nga tre subjekte të rivlerësimit, konkretisht: z. Arben Allajbeu, z. Arben Dyla, z. Bujar Memia.

Edhe për këto subjekte Komisioni ka marrë në analizë si masat disiplinore, ashtu dhe ankesat ndër vite ndaj tyre si prokurorë.

Znj. Keshi bën me dije se të gjitha materialet lidhur me këta tre subjekte, Komisioni ua ka shpërndarë në rrugë elektronike anëtarëve dhe ka arritur në konkluzionin që raportet janë të plota. Në këto kushte, i propozon Këshillit që t'i miratojë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Z. Ibrahim lexon vendimet, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar edhe në rastin e pesë projektakteve të mëparshme (origjinalet ndodhen në dosjen e protokolluar të seancës si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të KLP-së).

Këshilli vendosi:

- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin, z.Arben Allajbeu.
- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin, z.Arben Dyla.
- Miratimin e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin, z.Bujar Memia.

Z. Ibrahim i hedh në votim.



Miratohen me 9 vota pro

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Balla relaton projektaktin e vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin z. Genci Qana. Edhe për këtë subjekt, Komisioni ua ka shpërndarë gjitha materialet anëtarëve në rrugë elektronike dhe ka arritur në konkluzionin që raporti është i plotë dhe subjekti nuk ka asnjë problematikë. Në këto kushte, i propozon Këshillit që ta miratojë.

Z. Ibrahim e hedh në votim.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e dhjetë të rendit të ditës, miratimin e projektvendimit “Për miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar në vitin akademik 2020-2021, profili “prokuror”.

Z. Ibrahim vlerëson se Këshilli i Lartë i Prokurorisë është një aktor i dorës së parë në administrimin e fidanishtes së prokurorëve. Jemi ne ata që marrin vendimet në lidhje me numrin e kandidatëve për prokuror, që duhet të pranojë Shkolla e Magjistraturës. Ne bashkëpunojmë me këtë shkollë për ndërtimin e kurrikulave për formimin e prokurorëve të ardhshëm. Gjithashtu, ne kryejmë vetingun e kandidatëve për studentë, përpara se ata të hyjnë në Shkollën e Magjistraturës, si dhe vetingun përfundimtar të kandidatëve për prokuror, përpara se ata të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës, pasi ka shqyrtuar rreth 280 aplikime për t’u pranuar në provimin e pranimit, ka arritur në përfundimin që 14 prej tyre nuk i plotësonin kushtet.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Balla relaton mbi raportin e listës për kandidatët, pas vlerësimit paraprak të tyre nga Shkolla e Magjistraturës, e cila ka arritur në përfundimin se 14 syresh nuk i plotësojnë kriteret ligjore (11 janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kriterit të mesatares mbi tetë). Ai citon nenin 28, pika “ç”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; dhe nenin 10, pika 4 “f” të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sipas së cilës “kandidati duhet të ketë tre vjet vjetërsi pune”.

Komisioni i propozon Këshillit për të diskutuar mbi këtë problematikë, duke paraqitur kundërshtitë e tij në lidhje me kriterin e përcaktuar në nenin 9 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sipas të cilit kandidatët duhet të kenë mbi 3 vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas diplomimit (përfundimit të studimeve universitare) në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike dhe profesione të tjera ligjore, mësimdhënie ose pozicione



të tjera të barazvlefshme, në sektorin privat ose organizata të tjera ndërkombëtare. Si pasojë e këtij kriteri, janë skualifikuar dy kandidatë (për shkak se nuk kanë patur tre vjet punë). Në gjykimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, kjo pikë e Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, bie ndesh me nenin 28, pika “ç”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku nuk përcaktohet se vjetërsia e kandidatit do të llogaritet nga momenti i përfundimit të ciklit të studimeve universitare. Z. Balla citon për analogji edhe Vendimin nr. 35, dt 19.06.2017, të Shkollës së Magjistraturës, i cili është shfuqizuar nga Gjykata Administrative. Ai sjell në vëmendje dhe qëndrimin e ngjashëm të mbajtur për këtë çështje, pra kundër këtij kriteri përjashtues, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale i propozon Këshillit që të vendosë kundërshtimin e projektvendimit të Shkollës së Magjistraturës për mospranimin e kandidatëve që nuk kanë 3 vite pune pas përfundimit të Masterit. Komisioni vlerëson se asnjë kandidat, i cili nuk e plotëson këtë kriter, nuk duhet të penalizohet, me arsyetimin që kandidati mund të ndjekë edhe studimet universitare, edhe ndërkohë të jetë në marrëdhënie pune.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Staka pajtohet me relacionin e Komisionit. Ai citon ligjin nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Z. Staka shprehet se ky kriter dhe kjo praktikë përbëjnë shkelje dhe kapërcim të ligjit nga ana e Shkollës së Magjistraturës, e cila në Rregulloren e saj të Brendshme ka përjashtur nga e drejta e kandidimit aplikantët që nuk kanë 3 vite punë pas përfundimit të ciklit të studimeve universitare. Duhet përcaktuar se çfarë do të konsiderohet “përfundim” i ciklit të studimeve: “bachelor”, “masteri” apo “doktoratura”? Ai propozon që të bëhen sa më shpejt rregullime në këtë Rregullore.

Z. Balla e vlerëson pozitivisht faktin që Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është dhe anëtar i Bordit të Shkollës së Magjistraturës, pasi ky vendim mund t’i transmetohet personalisht dhe nëpërmjet Kryetarit, të këtij bordi.

Z. Beci pajtohet me konkluzionet e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Rregullorja e Shkollës së Magjistraturës, në këtë pikë, është në kapërcim të kufizimeve dhe përcaktimeve të bëra nga ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe bie ndesh me frymën e këtij ligji.

Z. Baza pajtohet me konkluzionet e Komisionit të Vlerësimit, por nuk është dakord për sa i përket relacionit të përgatitur nga ky Komision. Ai argumenton se Këshilli nuk ka tagër të vërë në diskutim një akt normativ, tashmë të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës.



Z. Ibrahim sqaron se Këshilli, nëpërmjet relacionit, nuk i kërkon Shkollës së Magjistraturës që të ndryshojë Rregulloren e saj, por i propozon që ajo të marrë parasysh kandidaturën e përjashtuar. Shkolla e Magjistraturës është e detyruar të marrë në konsideratë kundërshtimin e Këshillit, në bazë të nenit 30, pika a të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Është detyrë dhe e drejtë e Shkollës së Magjistraturës, nëse këtë kundërshtim mund ta reflektojë vetëm me një ndryshim në Rregulloren e saj të Brendshme.

Z. Ibrahim lexon vendimin si më poshtë:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, gërma “e” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 189 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; nenin 30, pika 4, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, vendosi miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar në vitin akademik 2020-2021, profili “prokuror”.

Bashkëlidhur, relacioni përkatës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Z. Ibrahim e hedh në votim

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim ndërpret mbledhjen plenare dhe i bën të ditur Këshillit rikthimin pas 10 minutash.

Z. Ibrahim rihap mbledhjen plenare dhe vijon me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës, miratimin e projektvendimit “Për bashkimin e procedurave administrative të filluara mbi bazën e vendimeve nr. 19, datë 27.01.2020 dhe nr.92, datë 10.04.2020, të Këshillit.

Z. Ibrahim informon lidhur me shpalljen nga Këshilli të vakancave në SPAK, organika e të cilit parashikohet të jetë me 15 prokurorë, të përzgjedhur prej KLP-së. Këshilli ka emëruar vetëm nëntë prej tyre, për shkak të vonesave në procesin e vetingut. Në këtë proces, nga 15 prej tyre, dy kanë paraqitur dorëheqje, kurse një tjetri i ka përfunduar mandati.

Në këto kushte, Këshilli ka shpallur tre vende vakante, në dy momente të veçanta kohore. Komisioni i Posaçëm që merret me shqyrtimin e aplikimeve dhe dokumentacionit ka qenë në punë e sipër dhe i propozon Këshillit bashkimin e këtyre dy procedurave në një të vetme.

Z. Ibrahim i jep fjalën z.Beci të relatojë në emër të Komisionit të Posaçëm.

Z. Beci relatton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendimin nr.19, datë 27.01.2020, ka vendosur: fillimin e procedurave për plotësimin e dy vendeve vakante për prokuror në Prokurorinë e Posaçme



Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Për këtë është bërë njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit dhe në përgjigje të tij kanë aplikuar 4 kandidatë: Dorina Bejko, Sotir Kllapi, Dritan Premçi dhe Vladimir Mara. Pas vlerësimit paraprak, me Vendimin nr.84, dt.18.03.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar listën e kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë.

Për shkak të dorëheqjes së një kandidature, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendimin nr.92, datë 10.04.2020 ka vendosur fillimin e procedurave për plotësimin e një vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Për këtë qëllim është bërë njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Në përgjigje të këtij njoftimi të dytë, kanë aplikuar dy kandidatë: Dorina Bejko dhe Sotir Kllapi. Projektvendimi i paraqitur nga Komisioni ka për qëllim të kryejë bashkimin e procedurave administrative për plotësimin e vendeve për të tre vakancat e shpallura sa më sipër. Në përfundim të këtij procesi synohet që Këshilli i Lartë i Prokurorisë të zhvillojë një procedurë të vetme, në përfundim të së cilës të vendosë emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme për efekt të efijencës. Në rastin konkret bëhet fjalë për të njëjtin pozicion, pra dy kandidatët kanë aplikuar si për vendin e parë, ashtu dhe për vendin e dytë. Për këtë arsye, duhet të zbatohet parimi i deburokratizimit dhe i efijencës, parashikuar nga Neni 18 i ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në këto kushte, Komisioni i Posaçëm vlerëson se këto dy procedura duhet të bashkohen në një të vetme, pasi kjo nuk përbën shkelje nga ana e organit procedues, konkretisht Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas parimit të diskrecionit. Komisioni propozon që vendimi për bashkimin e dy procedurave administrative të merret përpara vendimit për renditjen përfundimtare të katër kandidatëve të kualifikuar.

Për këtë qëllim, Komisioni propozon që ky vendim të përbëhet nga tri pika:

1. Të vendoset bashkimi i procedurave administrative të filluara mbi bazën dy vendimeve të Këshillit: atij nr.19, datë 27.01.2020 dhe atij nr.92, datë 10.04.2020
2. Të vendoset që vlerësimi përfundimtar dhe renditja e katër kandidatëve të kualifikuar të jetë e vlefshme për plotësimin e të tre vendeve vakantë për prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Të parashikohet hyrja në fuqi e vendimit dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.



Z. Ibrahim lexon projektvendimin si më poshtë:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a pika 1, gërma “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 48 pika 6 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 18 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 189 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Posaçëm për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, vendosi:

1. Bashkimin e procedurave administrative të filluara në bazë të dy vendimeve të sipërcituara.
2. Vlerësimi përfundimtar dhe renditja e katër kandidatëve të jetë e vlefshme për të tre vendet vakante.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim e hedh në votim.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e fundit të rendit të ditës:

Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, për prokurorin Kreshnik Ajazi”.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Balla për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Balla informon se, që në muajin Prill, prokurori Kreshnik Ajazi ka paraqitur një kërkesë për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit, mësimdhënie (30 orë leksione dhe 30 orë seminare), për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020, pranë Kolegjit Universitar të Biznesit në Tiranë, lënda “Procedurë Penale”. Z. Ajazi ka paraqitur të gjithë dokumentacionin përkatës. Nga verifikimet e bëra rezulton që veprimtaria e tij jashtë funksionit nuk çënon dinjitetin e Prokurorisë dhe se nuk krijohet perceptimi i njëanshmërisë gjatë ushtrimit të funksionit. Ngarkesa e tij në punë është më e ulët se mesatarja, pasi duke qenë edhe Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ai i ka përmbushur në kohë detyrat.

Z.Balla citon bazën ligjore, nenin 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Për këtë arsye, i propozon Këshillit që ta miratojë këtë kërkesë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.



Z. Ibrahimi lexon projektvendimin si më poshtë:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 143 të Kushtetutës së Shqipërisë; nenin 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 189, pika 1/c, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe nenin 8 të Rregullores së Këshillit, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, vendosi:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, për prokurorin Kreshnik Ajazi, si pedagog i jashtëm, lektor në lëndën “Procedura Penale” në Kolegjin Universitar të Biznesit Tiranë, në periudhën e semestrit të dytë të vitit akademik 2019 - 2020.
2. Të njoftohet për këtë vendim z. Kreshnik Ajazi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahimi e hedh në votim.

Miratohet me 9 vota pro.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETARI

Gent Ibrahimi



Shënim. Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjitha procedurave të rishikimit.

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. — datë — (bashkëngjitur kopjet e dokumenteve). Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 12/06/2020
Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

